

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-25-2547-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **“163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	DIGA Solutions L.L.C.
NUI	812208149
Adresa	Rr Bedri Berisha Alko Group 1 nr. 77
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044434776
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Kaltrina Bajrami
Adresa elektronike	digasolutions24@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

“163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender

28.03.2025 – Data e publikuar e Njoftimit për

Kontratë

22.04.2025 – Afati i fundit për Dorëzimin e

Tenderëve.

**27.05.2025 – Letër standarde e AK për sqarimin
e dokumenteve të prezentuara.**

**27.05.2025 – Përgjigje për AK Sqarim i
dokumentacionit.**

**10.06.2025 – B58 - Njoftim mbi Vendimin e AK-së,
Vendimi i AK rekomandim për dhënien e
Kontratës**

12.06.2025 – Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

**18.06.2025 – Vendim -Refuzim i AK-së për kërkesën
për rishqyrtim.**

**19.08.2025 – Vendimi i OSHP 0535/25 për kthim në
rivlersim të lëndës.**

**24.12.2025 – Letër standarde e AK për sqarimin e
dokumenteve të prezentuara.**

**27.12.2025 – Përgjigje për AK Sqarim i
dokumentacionit.**

**31.12.2025 – B58 - Njoftim mbi Vendimin e AK-
së, Vendimi i AK rekomandim për dhënien e
Kontratës**

**08.01.2026 – Vendim -Refuzim i AK-së për kërkesën për
rishqyrtim.**

**26.02.2026 – Vendimi i OSHP 0027/26 për kthim në
rivlersim të lëndës.**

**28.04.2026 – B58 - Njoftim mbi Vendimin e AK-
së, Vendimi i AK për anulimin e
aktivitetit të Prokurimit.**

28.04.2026 – Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

03.05.2026 - Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së,

06.05.2026 - AK refuzon Kërkesën për Rishqyrtim.

14.05.2026 - GEO parashtron Ankesën nr. 0322/26 në OSHP.

06.07.2026 – Vendimi i OSHP(2026/0311 + 2026/0322) për

kthim në rivlersim të lëndës.

07.08.2026 – B58 - Njoftim mbi Vendimin e AK-së,

Vendimi i AK për anulimin e aktivitetit

te Prokurimit.

10.08.2026 – Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

11.08.2026 – Përgjigja e AK-së, pa mundësohet qasje në

dokumentet e kerkuara.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

GOE DIGA Solutions L.L.C., ED - Construction SH.P.K., IMK - Industria Metalike E Kosoves SH.P.K, paraprakisht ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues sipas nenit 108/A të LPP-së. AK ka nxjerrë vendimin me datë 12.08.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim. Kopja e vendimit si dhe kopja e kërkesës për rishqyrtim i bashkëngjitet kësaj ankeses.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Më datë 07.08.2026 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar si dhe vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, me të cilin jemi informuar për eliminimin tonë nga procedura. Si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE) DIGA Solutions L.L.C.; ED - Construction SH.P.K.; IMK - Industria Metalike E Kosoves SH.P.K, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të Autoritetit Kontraktues (AK), pasi konsiderojmë se eliminimi ynë është bërë në mënyrë të padrejtë, duke qenë se ne kemi qenë i vetmi GOE i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit, gjë që mbështetet edhe nga dy vendimet paraprake me të cilat AK e kishte shpallur GOE tonë fitues, si dhe është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me faktet, provat materiale dhe vendimet e vetë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në të cilat AK pretendon se është mbështetur, me theks të veçantë se OSHP në vendimet nr. 2025/0535 të datës 30.08.2025 dhe nr. 2026/0027 të datës 26.02.2026 dhe vendimi i OSHP (2026/0311 2026/0322) i datës 06.07.2026, ka urdhëruar rivlerësim të procedurës dhe jo vendimmarrje të re jashtë dispozitivit të tyre, ndërsa AK ka dështuar të zbatojë në mënyrë të plotë dhe substanciale këto vendime duke mos kryer rivlerësim real dhe të plotë të ofertës sonë, por duke u kufizuar në konstatime formale të komisionit të vlerësimit për gjoja papërgjegjshmërinë e ofertës, gjë që bie ndesh me detyrimin ligjor dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik, rrjedhimisht, pas këtij eliminimi të padrejtë dhe pas vendimit të AK-së të datës 08.08.2026, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit të GOE-së së propozuar për dhënie të kontratës si dhe të operatorëve tjerë pjesëmarrës, deri më datë 11.08.2026 na është pamundësuar qasja në dokumente, nga të cilat, pas shqyrtimit, kemi evidentuar shkelje të dispozitave të Legjislacionit për Prokurim Publik si dhe veprime në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së, për më tepër, AK ka nxjerrë vendimin duke u thirrur në vendimet e OSHP-së nr. 535/2025 dhe 0027/2026 dhe vendimi i OSHP (2026/0311 2026/0322), nga të cilat rezulton qartë se vendimmarrja e AK-së është në kundërshtim me LPP për çka më poshtë do të paraqesim faktet dhe argumentet përkatëse.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Eliminimi bazohet mbi akte ende jo-përfundimtare gjyqësisht. Letra Standarde drejtuar Kërkuesit e mbështet eliminimin shprehimisht mbi tri Vendimet e OSHP-së, të cilat janë aktualisht objekt kontestimi aktiv pranë Gjykatës Administrative (lënda nr. 2026:147982, inicuar më 30.07.2026). Marrja e një vendimi përfundimtar administrativ mbi bazën e akteve ende nën shqyrtim gjyqësor bie ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe me detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të respektuar procesin gjyqësor në vazhdim.

2. Anulimi i aktivitetit të prokurimit bie ndesh me nenin 62.1 të LPP-së, pasi arsyeja e invokuar nuk figuron ndër arsyet shteruese të parapara me ligj.

Neni 62.1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik parasheh shprehimisht se Autoriteti Kontraktues mund të përfundojë një aktivitet prokurimi “vetëm për njërën nga arsyet” e numëruara në mënyrë shteruese: (i) shkelle ligjore e pandreqshme (neni 62.1.1); (ii) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që tejkalojnë në masë substanciale buxhetin e AK-së (neni 62.1.2); ose (iii) para hapjes së tenderëve, ndërprerja bëhet e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive, të paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues (neni 62.1.3). Asnjëra nga këto tri arsye nuk e mbulon situatën faktike të pretenduar nga Autoriteti Kontraktues: (a) neni 62.1.2 nuk aplikohet, pasi buxheti i miratuar për këtë aktivitet ishte €2.000.000,00, ndërsa të katër ofertat e paraqitura (nga €1.356.900,00 deri €1.972.300,00) ishin të gjitha brenda këtij buxheti, jo mbi të; (b) neni 62.1.3 nuk aplikohet, pasi kërkon që ndërprerja të bëhet “para hapjes së tenderëve”, ndërkohë që në rastin konkret tenderët ishin hapur, vlerësuar dhe rikthyer për rivlerësim tri herë që nga gushti 2025; për më tepër, kjo dispozitë kërkon që arsyeja të jetë jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues dhe e paparashikueshme, ndërkohë që, siç është elaboruar në pikën 4 më poshtë, mungesa e fondeve për vitin 2026 është pasojë e drejtpërdrejtë dhe e parashikueshme e vonesave të vetë institucioneve të paditura. Për më tepër, neni 62.2 i LPP-së kërkon që, kur anulimi bëhet pas njoftimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues të përfshijë një deklaratë me shkrim që parashtron me hollësi arsyet faktike dhe bazën ligjore konkrete (pikën përkatëse të nenit 62.1) mbi të cilën mbështetet anulimi – detyrim që Njoftimi B58 nuk e përmbush, pasi nuk specifikon nën cilën pikë të nenit 62.1 bie anulimi i pretenduar. Këtë interpretim e mbështet edhe praktika e vetë Organit Shqyrtues të Prokurimit i cili në raste të ngjashme (përfshirë ankesën nr. 898/25) ka konstatuar se anulimi i aktivitetit të prokurimit për arsye që nuk parashikohen shprehimisht në nenin 62 të LPP-së është i kundërligjshëm, duke rekomanduar drejtimin e çështjes te gjykata kompetente.

3. Verifikimi i dokumentacionit të dyshimtë të konkurrentit është bërë me vonesë të konsiderueshme, jo për faj të Kërkuesit.

Kërkuesi ka sinjalizuar dyshimet mbi autenticitetin e dokumentacionit të GOE “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Çevre Hizmetleri” A.Ş. që më datë 13.01.2026. Autoriteti Kontraktues e ka verifikuar këtë vetëm shtatë muaj më vonë (03–06.08.2026), duke konfirmuar në fakt të njëjtat dyshime. Kjo vonesë verifikimi nga ana e institucioneve, jo nga Kërkuesi, është shkaku kryesor i zgjatjes së procedurës përtej afateve normale dhe, rrjedhimisht, i skadimit të mjeteve buxhetore të pretenduar si arsye anulimi.

4. Mungesa e fondeve për vitin 2026 është pasojë e vetë-shkaktuar nga vonesat e institucioneve të paditura, jo mangësi origjinale financimi.

Financimi i këtij aktiviteti prokurimi është dokumentuar dhe miratuar zyrtarisht në tri faza të njëpasnjëshme, shumë përpara nisjes së procedurës: (i) në Propozim- Buxhetin e rishikuar të Komunës së Prishtinës të datës 27.09.2024, ku projekti figuron me vlerë të planifikuar €2.000.000,00 (€700.000,00 nga granti i përgjithshëm dhe €1.300.000,00 nga burimet vetanake); (ii) në Vendimin Nr. 01-400/03-162246/24 të datës 09.12.2024 të Kuvendit të Kryeqytetit – Komuna e Prishtinës, me të cilin miratohet zyrtarisht buxheti total i Komunës për vitin 2025 në shumën €128.100.224,00, ku

tabela e planit të buxhetit (duke përfshirë financimin e këtij projekti) përbën pjesë përbërëse të vet vendimit; dhe (iii) në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin fiskal 2025 (sipas nenit 8 LPP, dërguar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit më 31.01.2025), ku aktiviteti figuron nën numrin rendor 163, me të njëjtën vlerë prej €2.000.000,00 dhe datë të parashikuar fillimi 21.07.2025 – numër rendor që përputhet saktësisht me numrin e referuar nga vetë Autoriteti Kontraktues në titullin e Njoftimit B58 të datës 06.08.2026. Kjo dëshmon në mënyrë dokumentare dhe të pakontestueshme se financimi ishte i planifikuar, i miratuar me vendim zyrtar të Kuvendit dhe i mjaftueshëm që në fund të vitit 2024 – në masë që mbulon lehtësisht edhe ofertën më të lartë të paraqitur në procedurë. Autoriteti Kontraktues konfirmon vetë se i është drejtuar Drejtorisë së Financave vetëm më datë 15.07.2026 dhe 16.07.2026 për të verifikuar disponueshmërinë e mjeteve për vitin fiskal 2026 – çështje që lind vetëm sepse aktiviteti u zgjat përtej vitit fiskal 2025 për shkak të tri kthimeve të njëpasnjëshme të OSHP-së për rivlerësim (19.08.2025, 26.02.2026, 06.07.2026), të cilat janë objekt kontestimi në lëndën nr. 2026:147982. Bartja e financimit nga një vit fiskal në tjetrin kërkon miratim shtesë nga Kuvendi i Komunës, miratim që mungon jo për shkak të ndonjë mangësie origjinale, por si pasojë e drejtpërdrejtë e zgjatjes së paligjshme të procedurës. Ankuesi thekson parimin e njohur të së drejtës administrative sipas të cilit një organ publik nuk mund të thirret në një pengesë (këtu: skadimi i afatit fiskal origjinal) të krijuar drejtpërdrejt nga sjellja e vet e kundërligjshme apo e vonuar, për të shmangur një detyrim që do të kishte ekzistuar ndryshe. Nëse kthimet e OSHP-së konstatohen të paligjshme nga Gjykata, kjo prek drejtpërdrejt edhe vlefshmërinë e vetë arsyes buxhetore të anulimit, si pasojë e tyre.

5. Koha e anulimit ngre dyshim të arsyeshëm mbi arsyen e vërtetë të veprimit.

Anulimi i tërësishëm i aktivitetit u krye brenda 48 orësh pas paraqitjes së parashtrësës plotësuese të Kërkuesit (03.08.2026) me prova të reja mbi mosautenticitetin e dokumentacionit të konkurrentit, dhe menjëherë pas përgjigjes përfundimtare negative të Bureau Veritas (04.08.2026). Kjo sekuencë kohore, e bashkuar me faktin se çështja ishte ende sub judice, krijon përshtypje objektive të një veprimi të nxituar që parandalon shqyrtimin e themlit të çështjes.

6. Trajtim jo i barabartë mes projekteve në gjendje të njëjtë buxhetore.

Sipas informacionit të vetë Autoritetit Kontraktues (siç referohet në Letrën Standarde drejtuar GOE “Eing Com” & “Mavi Deniz”), pengesa e alokimit/bartjes së mjeteve buxhetore për vitin fiskal 2026 lidhet me mungesën e miratimit nga Kuvendi i Komunës – gjendje që prek në mënyrë të përgjithshme edhe projekte të tjera të Komunës, jo vetëm këtë aktivitet. Kërkuesi kërkon sqarim me shkrim mbi kriterin objektiv sipas të cilit pikërisht ky aktivitet prokurimi u zgjodh për anulim tani, ndërkohë që projekte të tjera me gjendje të njëjtë buxhetore vazhdojnë të mbeten aktive, në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të parashikuar në nenin 7 të LPP-së.

7. Kërkesë pezullimi paralel pranë Gjykatës.

Ankuesi njofton se çështja lidhur me ligjshmërinë e Vendimeve të OSHP-së dhe të

Vendimeve të Autoritetit Kontraktues mbetet aktualisht në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative, dosje nr. 2026:147982, ku është parashtruar edhe kërkesë shtesë lidhur me faktin e ri të anulimit të aktivitetit

8. Dëmi konkret dhe i vazhdueshëm i shkaktuar tashmë Kërkuesit si pasojë e mbështetjes së arsyeshme mbi rekomandimet e dyfishta si fitues.

Ne jemi rekomanduar fitues nga vetë Autoriteti Kontraktues dy herë rresht (Njoftimet B58 të datave 10.06.2025 dhe 31.12.2025). Mbi bazën e këtij rekomandimi të dyfishtë zyrtar, dhe të bindjes së arsyeshme se ishte i vetmi operator ekonomik që i përmbushte plotësisht kriteret e Dosjes së Tenderit, Kërkuesi ka ndërmarrë veprime konkrete përgatitore për ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë blerjen paraprake të materialeve dhe produkteve të domosdoshme për realizimin e projektit, si dhe duke mbajtur në fuqi sigurimin (garancinë) e tenderit gjatë gjithë kohëzgjatjes së zgjatur të procedurës (rreth 18 muaj). Ky dëm është real, i dokumentuar dhe në vazhdim rritje, dhe rrjedh drejtpërdrejt nga mbështetja në mirëbesim e Kërkuesit mbi veprimet e vetë Autoritetit Kontraktues, jo nga ndonjë rrezik biznesi i marrë pa bazë. Anulimi i aktivitetit, në vend që ta zgjidhë këtë situatë, e kristalizon dëmin si përfundimtar, pa i dhënë Kërkuesit mundësinë as të përfundojë kontratën për të cilën ishte përgatitur, as të shmangë koston tashmë të kryer. Kjo rrethanë forcon shtesë nevojën për pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të Njoftimit B58, siç kërkohet në Kreun II më poshtë.

9. Verifikim i pamjaftueshëm dhe konstatim jo-përfundimtar mbi falsifikimin e dokumentacionit të GOE „Eing Com“ & „Mavi Deniz Çevre Hizmetleri“.

Pavarësisht provave të reja vendimtare, ndërsa falsifikimi i certifikatës tatimore turke është konstatuar zyrtarisht nga vetë Komisioni i Rivlerësimit (me referencë konkrete te nenet 415, 383 dhe 390 të Kodit Penal), i njëjti trajtim nuk i është dhënë dokumentit „Inspection Report Nr. 314 R“ – i cili në letrën eliminuese trajtohet thjesht si „provë e pamjaftueshme, e pabesueshme dhe e paverifikueshme“, pa konstatim formal falsifikimi, edhe pse: (a) vetë institucioni lëshues i pretenduar, Bureau Veritas, ka konfirmuar zyrtarisht (21.05.2026 dhe 04.08.2026) se nuk mund të verifikojë origjinën, vlefshmërinë apo lëshimin e këtij dokumenti nga ana e tij; dhe (b) Presidenti i SAS Néodis Équipements ka konfirmuar zyrtarisht (03.08.2026) se fotografia e përfshirë në raport nuk mund të përkasë një inspektimi të vitit 2011, pasi vetë kompania është themeluar në 2019 dhe fotografia është përdorur pa autorizim. Kjo pamundësi kronologjike objektive (2019 pas 2011) përbën provë të fortë, të pavarur nga çdo interpretim subjektiv, të karakterit fiktiv të dokumentit. Mungesa e një konstatimi të plotë e formal të falsifikimit edhe për këtë dokument – me pasojat përkatëse sipas nenit 65.1.3 dhe nenit 66 të LPP-së (përgjashtimi nga pjesëmarrja në procedura të ardhshme) – përbën zbatim jo të plotë dhe të pabarabartë të detyrimit të verifikimit sipas nenit 59 LPP, dhe rrezikon integritetin e vetë procesit të prokurimit publik.

10. Mosveprim mbi kërkesat e përsëritura të Ankuesit për verifikim shtesë dhe raportim te organet kompetente.

Ankuesi ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme (parashtresat e datave 16.04.2026,

06.05.2026 dhe 04.08.2026) që AK të kryejë verifikim të plotë zyrtar të certifikatave ISO dhe të „Inspection Report Nr. 314 R“, si dhe të përcjellë çështjen te organet e ndjekjes penale në rast konstatimi falsifikimi. Deri më sot, Ankuesi nuk ka marrë konfirmim me shkrim nëse çështja e falsifikimit të certifikatës tatimore – e konstatuar zyrtarisht nga vetë AK – është përcjellë te Policia e Kosovës apo te Prokuroria e Shtetit, siç kërkohet nga natyra e veprës penale të konstatuar. Ky mosveprim, i kombinuar me anulimin e menjëhershëm të tërë aktivitetit në vend të dhënies së kontratës Ankuesit si i vetmi operator i mbetur i pacenuar nga defekte të konstatuara, ngre dyshim shtesë mbi qëllimin e vërtetë institucional.

II. KËRKESË

Bazuar në sa më sipër, Ankuesi i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit që:

1. Ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar;
2. Ta anulojë Njoftimin B58 të datës 06.08.2026 (anulimin e aktivitetit të prokurimit) dhe Letrën Standarde eliminuese drejtuar Ankuesit të së njëjtës datë;
3. Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të kryejë rivlerësim të plotë, individual dhe të arsyetuar të ofertës së Ankuesit, në përputhje me nenin 59 të LPP-së;
4. Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të plotësojë verifikimin dhe konstatimin mbi dokumentacionin e GOE „Eing Com“ & „Mavi Deniz Çevre Hizmetleri“, duke përfshirë shprehimisht dokumentin „Inspection Report Nr. 314 R“, në dritën e provave të reja të Bureau Veritas dhe SAS Néodis Équipements, dhe të zbatojë pasojat ligjore përkatëse sipas neneve 65.1.3 dhe 66 të LPP-së, përfshirë referimin te organet kompetente, nëse kjo nuk është bërë ende
5. Alternativisht, nëse rivlerësimi konfirmon se Ankuesi është i vetmi operator ekonomik i përgjegjshëm, të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të vazhdojë procedurën me dhënien e kontratës Ankuesit, në përputhje me nenin 61 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

G.O.E. DIGA Solutions L.L.C.; ED - Construction SH.P.K.; IMK - Industria Metalike E Kosoves SH.P.K deri në këtë fazë të procedurës i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme të cilat konsistojnë në përgatitjen e aplikimit për tender, përgatitjen e mjeteve juridike për apelin e vendimeve të kundërligjshme dhe shpenzime të konsiderueshme për përgatitje të fillimit të ekzekutimit të kontratës sipas njoftimit për dhënie të kontratës si dhe humbja e fitimit nga mosdhënia e kontrates si GOE i përgjegjshëm. Njëkohësisht, “GOE” do të kërkojë kompensimin e plotë të çdo dëmi material dhe jomaterial të shkaktuar, duke përfshirë pa kufizim edhe fitimin e munguar (fitimin e humbur), kostot

financiare,dëmtimin e reputacionit tregtar,si dhe çdo pasojë tjetër që rrjedh drejtpërdrejt ose tërthorazi nga këto veprime të kundërligjshme. Andaj, në rast se nuk kthehet ligjshmëria në këtë aktivitet, dëmet do të marrin dimension të paparashikueshëm për shkak të privimit nga e drejta për shpërblim me kontratë, të cilat do të detyrohet AK t'i kompensoj GOE”, në mbrojtje të plotë të interesave të tij ekonomike, financiare dhe ligjore, rezervon të drejtën që, në rast të vijimit të veprimeve të kundërligjshme, të ndërmarrë pa asnjë hezitim të gjitha mjetet juridike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë iniciimin e procedurave në të gjitha instancat hetimore, administrative dhe gjyqësore kompetente, me qëllim vendosjen e përgjegjësisë ligjore ndaj çdo subjekti përgjegjës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*